



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Politikën e Jashtme*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 19.02.2021, ora 09:30

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rend i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e infrastrukturës bashkiake V në shumën 80 milionë euro”. (*Komision për dhënie mendimi*)

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha Gjebrea, Ligoraq Karamelo, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Eglantina Gjermeni, Ervin Bushati, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Ditmir Bushati, Fatmir Velaj dhe Reme Lala.

**Mungojnë:**

Rudina Hajdari dhe Halit Valteri.

**Të ftuar:**

Elona Mistrovica – Drejtoreshë Drejtorie në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë  
Flauers Shoshi – Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)

Jovan Gjika – Koordinator i projekteve me KfW-në pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëmëngjesi!

Sot në mbledhjen e Komisionit të Politikës së Jashtme, datë 19 shkurt 2021, në rendin e ditës kemi vetëm diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe KFW Frankfurt am Main (KFW) për programin e infrastrukturës bashkiake V në shumën 80 milionë euro”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relator kemi kolegun Ervin Bushati.

Të ftuar kemi besoj zonjën Mistrovica, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, uroj që zonja të na shikojë edhe me video, si dhe zotin Shoshi, zëvendës drejtor të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta.

Mirë, fillojmë, pa humbur kohë. Besoj që për projektligjin do të na flasë zonja Mistrovica.

Zonja Zëvendësministre, fjala është për ju, por shikoj që nuk jeni ende në video.

**Elona Mistrovica** – Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje!

**Mimi Kodheli** – Jo, nuk ju shikojmë në video.

**Elona Mistrovica** – Përshëndetje të gjithëve!

**Mimi Kodheli** – Po, mirëmëngjesi!

**Elona Mistrovica** – Mirëmëngjesi!

Në fakt, doja të bëja një saktësim: unë nuk jam zëvendësministrja e Financave, por drejtoreshë e një drejtorie të Borxhit Publik, më saktë, e drejtorisë e cila trajton marrëveshjet financiare. Si e tillë, do të preferoja...

**Mimi Kodheli** – Uroj shumë që të bëheni një ditë, se mund të jetë “Rastësia, shprehje e domosdoshmërisë”, thoshin dikur.

Po, Elona, ju lutem, mund të vazhdoni.

**Elona Mistrovica** – Nëse do të jetë e mundur, do të preferoja që të bëhej fillimisht një prezantim i projektit nga Ministria e Energjisë. Duke qenë se pasqyrimi i termave financiarë nga ana e Ministrisë së Financave mund të jetë më i saktë ose, meqë e kam fjalën, mund të kaloj drejtpërdrejt tek termat financiarë...

**Mimi Kodheli** – Elona, jo, jo, rendin e të folurit e përcaktoj unë, jo ju. Ju do të flisni për termat financiarë, jeni e lutur të flisni për termat financiarë të marrëveshjes.

**Elona Mistrovica** – Faleminderit!

Atëherë, bëhet fjalë për një kredi, e cila, në fakt, vjen si një paketë financiare, e shoqëruar nga katër grante, dy prej tyre të qeverisë gjermane, të akorduara nëpërmjet KfW-së, një tjetër grant SECO dhe granti i katërt është grant i Bashkimit Europian. Në total është një paketë rreth 140 milionë euro, nga të cilat huaja zë një vend vetëm në shumën 80 milionë euro. Kjo hua ka një interes të përcaktueshëm në momentin e disbursimit, i cili si normë reference ka normën ICAPEURO plus 1 marzh (që është 0,55%). Për një informacion më tepër, ICAPEURO në momentin e negocimit të kësaj pakete financiare ka qenë 0,41%, duke bërë që aktualisht të flasim për një normë rreth 0,95%.

Gjithashtu, në termat financiarë të kësaj kredie kemi një tarifë menaxhimi të pagueshme vetëm një herë që është 0,5% e shumës së huas; kemi një komision angazhimi, i cili për dy vjetët e parë të kredisë është 0,125%, ndërsa pas dy vjetësh bëhet 0,25%. Maturimi i kësaj huaje është 15 vjet, nga të cilat 5 vjet janë pa pagesë principali.

**Mimi Kodheli** – Zonjë, kaq kishit?

**Elona Mistrovica** – Po. Për dëmet financiare, po.

**Mimi Kodheli** – Zoti Shoshi, fjala për ju.

**Flauers Shoshi** – Mirëmëngjesi, të nderur kolegë!

Të nderuar deputetë.

Dua t'ju paraqes qëllimin dhe objektivat e kësaj huamarrjeje. Ky projektvendimi synon miratimin në parim të marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që është huamarrësi, dhe KfW-ë, për financimin e programit infrastruktura bashkiake V, ku shuma totale është 80 milionë euro.

Qëllimi i këtij programi, infrastruktura bashkiake V, përfshihet në 8 bashki, në atë të Shkodrës, të Lezhës, të Kamzës, të Beratit, të Kuçovës, të Elbasanit, të Fierit dhe të Vlorës. Ky program ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si dhe përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve të bashkive të përfshira në këtë program.

Të nderuar deputetë, përveç sistemit të ujësjellës-kanalizimeve që do të ndërtohet ri, në dy qytete kemi dhe ngritjen e impianti të ujërave të ndotura, të cilat do ngrihen në Shkodër dhe në Berat.

Ky projekt, ku programet, le të themi më mirë, në vetvete do të implementohet në dy faza. Faza e parë është faza e fizibilitetit, e cila ka mbarur në dhjetor të 2020-s dhe faza e dytë ajo e zbatimit, futen projektimi, tenderimi, zbatimi dhe ndjekja e të gjitha këtyre hallkave nga konsulenca.

Për sa i përket ndarjes së shumës prej 80 milionë euro që jep KFW-ja, 68 milionë shkojnë direkt për rikonstruksionin ose rehabilitimin e sistemit të ujësjellësit, 10,5 milionë euro shkojnë për kanalizimet, kurse 1,5 diferenca që mbetet shkojnë për konsulencën.

Më vonë, në qoftë se nga ana e deputetëve do të ketë pyetje, se si janë të shpërndara këto shuma sipas qyteteve, ne kemi një tabelë, e cila është e shpërndarë, sipas qyteteve që përfitojnë, për sa i përket këtij investimi, këtij granti që do të merret nga KFW-ja.

E nderuar kryetare, mund t'i them për secilin qytet sesa përfitojnë?

**Mimi Kodheli** – Ju lutem, po.

**Flauers Shoshi** – Atëherë, Berat- Kuçovë përfiton 12,8 milionë euro. Elbasani përfiton 13,8 milionë euro. Fieri 13,5 milionë, Kamza 13,2 milionë. Lezha 16, 1 milionë. Shkodra 19,5 milionë dhe Vlora 18 milionë. Siç e thashë, dy qytete Shkodra dhe Berati, kanë të përfshira edhe ITN-ë, që është trajtimi i impiantit të ujërave të ndotura.

Kaq kam, jam i hapur për çdo pyetje që mund të keni, zonja kryetare ose deputetët.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zoti Shoshi!

Kolegu Bushati, fjala për ju.

**Ervin Bushati** – Dëgjohem?

**Mimi Kodheli** – P o.

**Ervin Bushati**- Atëherë, faleminderit të gjithë kolegëve, kryetare!

Në fakt, këto janë investimet që duam dhe që duhen, në radhë të parë se kanë të bëjnë me sistemin e kanalizimeve dhe në radhë të dytë, përfitoj nga rasti për të falënderuar në mënyrë të veçantë KFW-ë, shtetin gjerman, sepse KFW-ja në Shqipëri është investitori më i madh strategjik. Ka investuar deri më sot mbi 1 miliardë euro dhe kjo shumë që vjen sot, mbi 80 milionë, e cila miratohet me terma reference interesi minimale fare, tregon vazhdimësinë dhe përkushtimin e KFW-ë dhe të qeverisë gjermane për të investuar jo vetëm në Shqipëri, por në një sektor kaq të rëndësishëm, siç është infrastruktura dhe i gjithë sistemi që kemi ne i kanalizim-ujësjellësve sot në Shqipëri. Në fakt, është një vepër e madhe e KfW-së dhe e qeverisë gjermane, kështu që meriton një mirënjohje të veçantë nga ne si Komision i Jashtëm, por sigurisht dhe nga të gjitha strukturat dhe shoqëria shqiptare.

Të gjitha bashkitë që përfshihen, në radhë të parë marrin jo vetëm fonde, të cilat ndahen sipas popullatës, në proporcion, pra kemi Vlorën, Shkodrën, Fierin, Elbasanin, që marrin shifra të konsiderueshme, por në vetvete nuk është ky investimi kryesor. Investimi kryesor është ai që vjen në teknologji, në know-how, si dhe në mënyrën e operimit të këtyre ujësjellës-kanalizimeve dhe infrastrukturës shumë të rëndësishme e strategjike për Shqipërinë.

Shpresoj dhe mendoj se është përshtatur gjithë strategjia e KfW-së dhe e qeverisë gjermane në Shqipëri, dhënë dhe me ndarjen e re territoriale, sepse si iniciativë e si investim ka nisur që më parë, me 470 komunat në Shqipëri. Kështu që, integrimi duhet të ketë prioritet. Kam përshtypjen se edhe nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, ndarja territoriale duhet të ridimensionojë të gjitha investimet dhe mënyrën e funksionimit të një numri të ndarë dhe të madh komunash e entesh rregullatore apo zbatuese në terren, që kanë qenë në terren, me 61 bashki funksionale, të cilat sot kanë të gjitha kapacitete, që shumë shpejt t'u ofrojnë qytetarëve, ashtu siç ka ndodhur në shumë bashki, si në Korçë, Pogradec, Lezhë, që të kenë 24 orë ujë të pijshëm dhe shërbime 100 % funksionale për popullatën e të gjithë Shqipërisë. Kjo sidomos për vende, të cilat kanë prioritet e angazhim strategjik për sa i përket dhe potencialit turistik, siç janë: Shkodra, Vlora, Berati, të cilat duhet të ofrojnë patjetër më të mirën, e jo vetëm për qytetarët shqiptarë, të cilët e meritojnë dhe e kanë këtë angazhim e investim nga qeveria gjermane, por edhe turistët potencialë, që mund të vijnë shumë shpejt me të kaluar pandemia.

Faleminderit! Shpresoj që të miratohet me votat e maxhorancës dhe ato të minorancës, në këtë rast, sepse është një investim strategjik.

Falënderojmë edhe një herë KfW-në dhe qeverinë gjermane për këto donacione kaq të mëdha, qoftë në formë granti, shumica, por edhe kur janë kredi me norma interesi minimale, që janë edhe më të ulëta se sa inflacioni.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Ervin!

Kush ka pyetje, komente, diskutime?

Nënkryetari Gjoni, fjala për ju!

**Ralf Gjoni** – Faleminderit, kryetare!

Së pari, do të kërkoja pak më tepër seriozitet nga ana e ekzekutivit, ndaj Komisionit për Politikën e Jashtme dhe ndaj Kuvendit. Mendoj që, pa asnjë paragjykim për zonjën e nderuar nga Ministria e Financave, mendoj se këtu duhej të kishim të pranishëm të paktën dikë në nivel ministri, që ta prezantonte këtë projektligj.

Kam dy komente të vogla, për të cilat marr shkas nga fjala e kolegut Bushati. Është shumë mirë që KfW-ja po ndihmon Shqipërinë, por nuk është investim. Do të doja të ishte e qartë për të gjithë kolegët: ky nuk është investim, por është një hua që po marrim. Interesat janë interesante, patjetër. Është një hua, nuk kemi ndonjë gjë për t'u thënë faleminderit gjermanëve, kur ne po e marrim hua dhe po u paguajmë edhe interes, sado i vogël qoftë ai.

Kam vetëm një paqartësi, zonja kryetare, teksa po lexoja relacionin e projektaktit. Shumë mirë që merret hua, kur s'kemi para për të furnizuar me ujë qytetet e Shqipërisë. Si qytetar i Tiranës, do të doja shumë që e njëjta gjë të ishte edhe për kryeqytetin, sepse jemi i vetmi kryeqytet në Ballkan, ku qytetarët faturohen për ujë të pijshëm, por uji nuk pihet dot, sepse është tejet i ndotur nga pikëpamja e çdo lloj standardi shëndetësor.

Pyetja ime konsiston në mënyrën se si do të shpërndahen këto investime. Në relacion, zonja kryetare ndoshta mund të më ndihmoni, se sepse nuk di se cilit prej dy përfaqësuesve të ekzekutivit duhet t'ia drejtoj këtë pyetje. Në relacion thuhet se investimet që do të mbulohen nëpërmjet huasë, sipas përcaktimeve në këtë projektligj, do të synojnë kryesisht ndërhyrjet që synojnë përmirësimin e aksesit dhe të qëndrueshmërisë më të madhe të trashëgimisë kulturore, pasurive natyrore, si dhe përmirësimin e infrastrukturës në të gjithë territorin e vendit në kuadër të planeve zhvillimore lokale.

Desha thjesht ta kuptoja këtë para se të votojmë. Bëhet fjalë për furnizim me ujë, kanalizime apo për mbështetje të trashëgimisë kulturore? Në ç'kuptim po e mbështesin trashëgiminë kulturore përmes kësaj huaje gjermane?

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, Ralf!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Urdhëroni, zoti Shoshi për t'ju përgjigjur pyetjve që bënë!

**Flauers Shoshi** – Faleminderit!

Unë kam këtu të pranishëm edhe përfaqësuesit e KfW-së, i cili mund të na japë panoramë më të qartë për të gjitha ndërhyrjet për ujësjellës-kanalizimet.

Përpara se t'ia jap fjalën, do të doja të thosha se për Tiranën është aktualisht Banka BEI, e cila po investon rreth 80 milionë euro për furnizimin me ujë dhe kanalizimet e kryeqytetit dhe BERZH-i me 15 milionë euro. Nuk është se Tirana është lënë në veçanti, por është e përfshirë në një projekt tjetër, kurse për sa u përket investimeve të KfW-së dhe çfarë ato prekin direkt, një përgjigje më të detajuar, më të saktë e jep përfaqësuesi i KfW-së.

**Mimi Kodheli** – Urdhëroni, zoti Gjika!

**Jovan Gjika** – Mirëdita!

Programi synon rehabilitimin e infrastrukturës në ujësjellës, kanalizime dhe trajtim ujërash të përdorur në dy qytete, pra do të kemi dy impiante, një në Shkodër dhe një në Berat.

Në paketën e madhe prej 130 milionë, që është programi, përfshihen të gjitha bashkitë dhe nga kjo kredi, 80 milionë, siç e shpjegoi edhe zoti Shoshi, 46,8 milionë shkojnë drejtpërdrejt për investim në ujësjellës, 10,5 milionë shkojnë për kanalizime dhe impiante,

ndërsa 1,5 milionë janë për shërbime konsulence që janë shërbimet e projektimit, pra hartimi i projekteve të detajuara teknike dhe supervizioni i punimeve në terren.

Pra, si paketë është e detajuar mirë dhe këto detaje janë pjesë e një aneksi të shpërndarjes së fondeve që lidhen me marrëveshjen veçantë teknike të programit që përmbledh të gjitha financimet, pra edhe kreditë, edhe grantet. Nuk e di a vjen për miratim në parlament vetëm kredia dhe grantet nuk vijnë. Ndoshta ky aneks nuk e shoqëron marrëveshjen e kredisë, sepse është pjesë marrëveshjes së veçantë, prandaj ndoshta këto të dhëna nuk i janë bashkëngjitur marrëveshjes së huas, por janë pjesë e të gjithë paketës së marrëveshjeve, hua dhe grande, të këtij programi në tërësi.

**Mimi Kodheli** – Në fakt, t’u them të drejtën, unë besoj se duhej të vinte, të paktën, në Komisionin e Ekonomisë, pavarësisht se në Komisionin për Politikën e Jashtme ratifikimet e marrëveshjeve kanë një tjetër këndvështrim mbi bazën e të cilit diskutohen dhe arsyet pse këto marrëveshje vijnë edhe në Komisionin e Politikës së Jashtme.

Gjithsesi, unë mendoj dhe besoj se sa më shumë informacion të ketë për deputetët, qofshin këta të Komisionit për Politikën e Jashtme apo të ndonjë komisioni tjetër, aq më mirë do të ishte për të bërë transparencë dhe për të kuptuar më drejtë që kjo hua me këto interesa për sa shtyhet, nga pikëpamja gjeopolitike brenda vendit, ku shkojnë këto investime, kush ka më shumë nevojë, cilat janë qytetet më të rëndësishme, si është qasja ndaj banorëve, gjithashtu edhe ndaj zhvillimit të turizmit në këto rajone, dhe cila është mundësia financiare e buxhetit të shtetit shqiptar për të paguar më pas hua, pavarësisht, e ritheksoj, se interesi i përcaktuar në momentet e disbursimit është i favorshëm për shkak se marzhi është relativisht i ulët, madje shumë i ulët, në një kohë kur maturimi prej 15 vjetësh, të paktën në 5 vjetët e parë, do të jetë një periudhë *grace* pa pagesë principali.

Kështu që, zoti Gjoni, edhe në rastet kur mungojnë përfaqësuesit e lartë të Ministrisë së Financave, ke fatin të kesh në krye të Komisionit për Politikën e Jashtme një financiere të vjetër, kështu që e kompensojmë edhe me njëri-tjetrin mungesën e tyre, dhe vëzhgimi ju është i drejtë që këtu në komision Ministria e Financave duhet të përfaqësohet me staf politik dhe jo teknik, që do të thotë zëvendësministrja e sipër. Dakord, do ta zhbëjmë këtë mungesë informacioni edhe me njohuritë tona joprofane në këtë fushë.

Po, zoti Sterjovski.

**Vasil Sterjovski** – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fillim dua të shpreh mbështetjen time për këtë projektligj, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe KfW Frankfurt am Main (KfW).

Në fillim dua të shpreh një falënderim për qeverinë shqiptare, por edhe për Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve për financimin e projektit të ujësjetllësit të Pustecit në vitin 2021. Pas 30 vjetësh më në fund Bashkia e Pustecit, të gjitha fshatrat do të kenë ujë të pijshëm 24 orë.

Kam një kërkesë për Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës Kanalizimeve që të kenë parasysh edhe mbështetjen për rregullimin e pjesës së kanalizimeve në Bashkinë e Pustecit për faktin se kjo bashki, 90% e territorit të saj, përkon me Parkun Kombëtar të Prespës që është një zonë e shpallur turistike; kemi edhe një fshat që është përzgjedhur të “100 fshatrat turistike”. Duke marrë shkak edhe nga pozicioni i fshatrave që ndodhen buzë liqenit të Prespës, besoj se duhet të zgjidhet ky problem që ujërat të trajtohen para se të derdhen në liqen dhe të ndotin liqenin e Prespës.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, kolegu Sterjovski!

Më vjen mirë që realisht ky investim prek edhe një zonë, të cilën ju e përfaqësoni denjësisht. Besoj fort në zbatimin e saktë të projekteve dhe vënien në rrugë të drejtë të një investimi shumë të rëndësishëm, siç është ai në fushën e ujësjetllës kanalizimeve Jemi në një shekull që këtë duhet ta kishim zgjidhur me kohë, por shpresojmë më të mirën për periudhën në vazhdim.

Nëse nuk kemi gjë tjetër, atëherë ju ftoj të kalojmë në votim. Kush është dakord në parim për ratifikimin e marrëveshjes? Shikoj që kolegët janë të gjithë dakord: zoti Bushati, zoti Marto, zonja Gjermani, zoti Gjoni, zonja Gjebrea, zoti Sterjovski, zoti Karamelo, zonja Hysi, zoti Shtjefni, zoti Shameti, zoti Hyseni, zonja Braha dhe zonjën Lala. Kërkoj ndjesë edhe kolegun Valteri.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord për miratimin në tërësi të projektligjit? Shikoj që jemi të gjithë dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.



Miratohet.

Fundjavë të mbarë!

Faleminderit!

Mbyllet mbledhja.

**MBYLLET MBLEDHJA**